



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.41/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicë të Veriut të paraqitur kundër Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen më datë 12.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 17.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.41/2025, e datës 17.09.2025, parashtruar nga subjekti politik, Srpska Lista me seli në Mitrovicë të Veriut, kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 17.09.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Srpska Lista në të cilën thekson se më 15.09.2025 në orën 10:40, subjekti politik LVV, ka paraqitur një ankesë PZAP, të pabazuar Anr.37/2025, kundër subjektit politik Srpska Lista, duke insistuar se subjekti i tyre politik, ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës nr. 08/L-228, duke mos paraqitur asnjë provë, përveç trillimeve që nuk përputhen me faktet.

Me paraqitjen e ankesës së pabazuar, Lëvizja Vetëvendosje ka shkelur nenin 34, pika 1, nënpika 10 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës nr. 08/L-228, i cili thekson se nuk lejohet abuzimi me të drejtën e ankesës, ose paraqitja e ankesave të rreme, të pavlera dhe irrituese për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Më tej në ankesë theksohet se sjellja e Lëvizjes Vetëvendosje është e papranueshme dhe tregon për abuzim me të drejtën e ankesës, duke përfaqësuar një përpjekje për të shfrytëzuar mekanizmin

institucional që merret me ruajtjen e të drejtave dhe demokracisë për një fushatë politike, gjë që është e papranueshme.

Kërkojnë nga PZAP-i, që të pranojë ankesën si të bazuar, të konstatojë se Lëvizja Vetëvendosje ka shkelur LZP si dhe të shqiptojë një dënim të përshtatshëm për Lëvizjen Vetëvendosje, në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili do të kishte edhe karakter parandalues pro futuro.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik LVV, sqaron se ankesa e datës 15.09.2025 ishte e bazuar në provë të qartë dhe të pakontestueshme. Gjatë tubimit të hapjes së fushatës zgjedhore më 13.09.2025, Srpska Lista ka ekspozuar publikisht parullën "SVI ZA BRATA MILANA", duke shprehur përkrahje për Milan Radojiçiq, i dyshuar për terrorizëm dhe krime lufte, dhe i shpallur në kërkim nga institucionet e Republikës së Kosovës. Ky fakt është i dokumentuar me fotografinë e bashkëngjitur në ankesën tonë.

Në aspektin juridik, Neni 34, par.1, pika 11 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme ndalon përdorimin e gjuhës, shkrimit ose simboleve që nxisin urrejtje ndaj personit ose tjetrit kandidat gjatë periudhës së fushatës. Ndërsa Neni 119 dhe Neni 39, par. 3, i po të njëjtit ligj, e garanton të drejtën e subjekteve politike për të ushtruar ankesa për shkeljet zgjedhore. Në rastin konkret, slogani i Srpska Listës është një veprim që nxit përçarje dhe glorifikon një person të shpallur në kërkim, prandaj ngritja e ankesës së LVV-së, ishte veprim i justifikuar për të adresuar shkelje të tillë. Në këtë kuptim, ankesa e tyre ka qenë ushtrim legjitim i së drejtës së parashtruar me ligj.

Më tej në përgjigje shtojnë se pretendimi i Srpska Listës për "abuzim të së drejtës së ankesës" nuk qëndron. Ligji për Zgjedhjet parashikon se çdo subjekt politik ka të drejtë të parashtojë ankesë kur konstaton shkelje të dispozitave. Ky është një mekanizëm demokratik dhe nuk mund të cilësohet abuzim kur ankesa mbështetet në prova.

Si përfundim, ankesa e Srpska Listës është e pa bazuar në ligj dhe prova ndërsa ankesa e LVV-së e datës 15.09.2025 është bërë në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe e bazuar në provë, Prandaj, bazuar në të lartcekurat, kërkojnë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa të refuzon ankesën si të pabazuar.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shikimit të shkresave të lëndës si dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Srpska Lista, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se çdo subjekt politik mund të paraqesë ankesë ndaj një subjekti tjetër politik kur supozon se i'u janë shkelur apo i'u janë cenuar të drejtat gjatë fushatës zgjedhore siç parashihet edhe me Nenin 39 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paragrafi 3. *"Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqesë ankesë në PZAP*

brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i do të vendosë për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj”.

Bazuar në te lartcekurat subjekti politik LVV, përmes ankesës ZLA. nr.37/2025 të datës 15.09.2025, ka paraqitur pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e supozuar nga subjekti politik Srpska Lista, se gjatë tubimit të hapjes së fushatës zgjedhore më datë 13.09.2025, ka ekspozuar një parullë ne përkrahje për Milan Radojiçiq, qe përbënë shkelje te rregullave zgjedhore, mirëpo një pretendim i tille në mungesë të provave nuk ishte vërtetuar nga ana e Panelit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje” ka “abuzuar me te drejtën e ankesës”, pasi qe sipas LZP ne mënyrë decitive ka parapare se çdo subjekt politik mund te ushtroj ankese kur pretendon se i’u shkelur ndonjë dispozite e këtij Ligji, andaj pretendimet e theksuara si më lartë nuk përbëjnë shkelje të Kodit të Mirësjelljes.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.41/2025, datë 17.09.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.